



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.8, datë 16.01.2023

MBI

**“VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS PËR PROKURORIN
KLEDIAN LLAHO, KANDIDAT PËR POZICIONIN E DREJTUESIT TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË SARANDË”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës, nenet 159, pika 1 dhe 2 germa “a” dhe 189, pika 1, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 32 dhe 48 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pikën 5 të nenit 9 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” dhe në germën “ç”, pika 8, Seksioni Ç, të Kreut VI, të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve” e ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës për prokurorin Kledian Llaho, kandidat për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për prokurorin Kledian Llaho, kandidat për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidatit prokuror Kledian Llaho të vijojë me procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.
3. Të njoftohet për këtë vendim zoti Kledian Llaho.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 16.01.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË




ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Sokol Stojani



ANËTAR
Bujar Sheshi



ANËTAR
Nurihan Seiti



ANËTAR
Eloida Goxhi



ANËTAR
Esmeralda Keshi



ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirela Bogdani



ANËTAR
Arta Mandro



ANËTAR
Ledina Riza

